



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

KONTRATA

Numri i kontratës: 101-24-11163-2-3-6/C151

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS (në vijim "Autoriteti Kontraktues"), në njëzën anë;
dhe

Kompania e Sigurimeve të Përgjithshme SIGURIA, Prishtinë, (Rr. Qamil Hoxha, nr. 51, E-mail: *info@ks-siguria.com*, Tel.: +383 38 600 848) (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Servisimi i automjetit BMW 520 X Drive M1;

Lot 3: Sigurimi TPL, TPL Plus dhe Kasko si dhe Kontrolla teknike

me numër prokurimi: **101-24-11163-2-3-6 (KU101 24 043 236)**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë:

Lot 3: Sigurimi TPL, TPL Plus dhe Kasko si dhe Kontrolla teknike

1.2 Kontrata hynë në fuqi me nënshkrimin e kontratës dhe përfundon me implementimin e Kontratës.

1.3 Afati kohor i kryerjes së shërbimeve nuk mund të jetë më shumë se **5 ditë** nga data e marrjes së kërkesës nga AK.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë:

Lot 3: Automjeti do të dërgohet për kontrollë teknike

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **933.03 €** (nëntëqind e tridhjetetë euro e tre centë).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës .

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të shërbimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshhtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res-judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatë e specifikuar në KVK, në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.




KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Afatet kohore	1.3	<ul style="list-style-type: none"> Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e kontratës dhe përfundon me implementimin e Kontratës. Afati kohor i kryerjes së shërbimeve nuk mund të jetë më shumë se 5 ditë nga data e marrjes së kërkesës nga AK.
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	<ul style="list-style-type: none"> Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	<ul style="list-style-type: none"> Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe
Kualiteti	6	<ul style="list-style-type: none"> Kualiteti i shërbimeve dhe furnizimeve në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit. Autoriteti Kontraktues do t'ia bëjë pagesat operatorit ekonomik pas kryerjes së shërbimeve dhe pas konfirmimit nga Menaxheri i kontratës se furnizimeve janë kryer në pajtim me kërkesat në Dosje të Tenderit dhe në pajtim me kushtet e parapara në kontratë.
Vonesat në ekzekutim	8	<ul style="list-style-type: none"> Dëme të likuiduara: Autoriteti Kontraktues, për vonesë në furnizim, operatorit ekonomik mund t'ia kalkulojë dëmet e likuiduara 0.25% në ditë deri në 10% të vlerës së kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	13.1	<ul style="list-style-type: none"> Mosmarrëveshjet do të provohen të zgjidhen në mënyrë miqësore. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë lënda do të kalojë në gjykatën kompetente siç është paraparë në pikën vijuese: 13.2
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	13.2	<ul style="list-style-type: none"> Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve e cila mund të lind gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate, nëse nuk është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, lënda do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në pajtim me ligjin në Kosovë.

Shënim:

Kontratës i bashkëngjitet kopja e ofertës financiare të Ofruesit të Shërbimeve

Për Autoritetin Kontraktues KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS		Për Ofruesin e Shërbimeve Kompania e Sigurimeve të Përgjithshme SIGURIA	
Emri dhe mbiemri	Xhemail Halili	Emri dhe mbiemri	<i>Arten Ahmeti</i>
Pozita:	Drejtor i Drejtorisë për Prokurim	Pozita:	<i>Kordinator</i>
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	13.11.2024	Data:	<i>13/11/2024</i>
Vula:		Vula:	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Titulli: Servisimi i automjetit BMW 520 X Drive M1, ndarë në tri Lot-e:
Lot 3: Sigurimi TPL, TPL Plus dhe Kasko si dhe Kontrolla teknike
Nr. i Prokurimit: 101-24-11163-2-3-6 dhe Nr. i Brendshëm: KU101 24 043 236

PËRSHKRIMI I ÇMIMIT

Nr.	Emërtimi i shërbimit	Njësia matëse	Sasia	Çmimi me TVSH(€)	TOTALI me TVSH
1	Sigurimi TPL	Vit	1	233.1	233.1
2	Sigurimi TPL Plus	Vit	1	69.93	69.93
3	Sigurimi KASKO	Vit	1	600	600
4	Kontrolla Teknike	Vit	1	30	30.00
GJITHSEJ OFERTA ME TVSH					933.03

Shënim:

Operatorë ekonomikë duhet t'i japin çmimet reale të tregut për shërbimet e ofruara.
Çmimet jo-normalisht të ulëta dhe çmimet më të larta se çmimet reale të tregut do të trajtohen në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik.

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT	
EMRI I KOMPANISË	KS SIGURIA
ADRESA E PLOTË	Rr.Qamil Hoxha Nr.51
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI	Artan Ahmeti
POZITA	Kordinator
NËNSHKRIMI	
DATA	28.10.2024
VULA	

SIGURIA
KOMPANIA E SIGURIMIT PRISHTINE 07 INSURANCE COMPANY